



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura III**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 40  
Prishtinë, më 14. 07. 2009, ora 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**P R O C E S V E R B A L**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismet Beqiri – kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Nerxhivane Dauti, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Naim Rrustemi, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

**Mbledhjen e mbikëqyrën:** Elita Vokshi - OSBE, Lejla Selimi OSBE, Rrezarta Ahmeti - KDI dhe Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit.

Të ftuar: Shqipe Krasniqi - Agjencia për Barazi Gjinore dhe Sadete Demaj – Zyra për Qeverisje të Mirë.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Visar Krasniqi

***Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë***

**R e n d d i t e**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Takim pune me Zyrën për Qeverisje të Mirë, me Zyrën për Barazi Gjinore dhe me Agjencinë Kundërkorrupsionit, sipas pikës 16 të Planit të Veprimit – Sfidat e Raportit të Progresit,
3. Shqyrtimi i peticioneve,
4. Të ndryshme.

*Kryetari i propozoi Komisionit të mos shqyrtohen pikat 3 dhe 4 të rendit të ditës.*

*Arsyetim ishte koha e kufizuar.*

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.*

## **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.*

## **2. Takim pune me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe me Zyrën për Barazi Gjinore, sipas pikës 16 të Planit të Veprimit – Sfidat e Raportit të Progresit**

**Kryetari** - I përshëndeti të ftuarit e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe të Zyrës së Kryeministrit për Qeverisje të Mirë. Theksoi se kemi vendosur të zhvillojmë takim me këto dy zyra që drejtpërsëdrejti të njoftohemi për vështirësitë me të cilat po ballafaqohemi gjatë zbatimit të Ligjit për barazi gjinore, si dhe për detyrimet që rezultojnë nga pika 16 e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

Theksoi se kemi debatuar për nevojën për plotësimin dhe për ndryshimin e Ligjit për barazi gjinore, i cili promovon vlera dhe mundësi të barabarta pa marrë parasysh përkatësinë gjinore.

Komisioni ka vërejtur se gjatë zbatimit të Ligjit ka hasur në shumë vështirësi për shkak të vakuimit legjislativ, që nuk janë indenfikuar në kohën e hartimit.

Sipas Raportit të Progresit të vitit 2008 për Kosovën, pika 16 .1, Kuvendi i Kosovës e ngarkon Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione t'i mbikëqyrë përgjegjësitë e Agjencisë për Barazi Gjinore, Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe Agjencinë Kundërkorrupsionit, të nxjerrë rekomandime përkatëse lidhur me dyfishimin e punëve dhe ta njoftojë Qeverinë e Kosovës.

**Shqipe Krasniqi** – Diskutoi për rëndësinë e Ligjit për barazi gjinore dhe kërkoi të merret nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit. Në këtë kontekst, tha se në vitin 2008, Qeveria e ka miratuar Programin e Agjencisë për Barazi Gjinore, që është dokument bazë me të cilin funksionon Agjencia për Barazi Gjinore.

Kërkoi nga Komisioni të fillojë veprime procedurale për miratimin e programit nga Kuvendi dhe ta miratojë Rezolutën sipas nenit 4 të Ligjit për barazi gjinore. Diskutoi dhe njoftoi për punën që është duke u bërë në këtë agjenci. Për Projektligjin kundër dhunës në familje, tha se e ka kaluar fazën e harmonizimit me *Acquis Communautaire*, megjithëkëtë do të ketë implikime buxhetore.

**Sadete Demaj** – Njoftoi për funksionimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe duke u mbështetur në Raportin e Progresit tha se ka angazhim në fushën e legjislacionit dhe të programeve të cilat çojnë në promovimin e të drejtave të njeriut. Me këtë rast shtoi se Qeveria e Kosovës i ka miratuar dokumentet me qëllim të përmbushjes së detyrimeve që dalin nga Raporti i Progresit për Kosovën, si vijon:

- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës për vitin 2009 - 2011,

- Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptas në Republikën e Kosovës 2009 - 2015,
- Strategjia dhe Plani kombëtar i veprimit për te drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009 - 2013,
- Plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara.

Në çdo 6 muaj Zyra për Qeverisje të Mirë publikon raport për aktivitetet e zhvilluara. Kjo Zyrë, për shqetësimet e qytetarëve, zhvillon dy lloje hulumtimesh: për nivelin dhe format e diskriminimit dhe perceptimin e nëpunësve civilë për diskriminimin në administratën publike.

**Sanije Aliaj** – Pyeti: *A duhet të miratohet Programi për barazi gjinore nga Kuvendi i Kosovës?*

Pyeti edhe për formimin e institutit për hulumtime gjinore dhe a përputhet me ndarjen e buxhetit të vitit 2009. Nga znj. Sadete Demaj kërkoi të njoftohet a parashihet në program ndonjë hulumtim për diskriminimin në sektorin privat.

**Drita Maliqi** – Shprehu shqetësimin për mosemërimin e drejtorit të Agjencisë për Barazi Gjinore. Pyeti: *Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohen Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Agjencia për Barazi Gjinore?*

**Shpresa Murati** - Pyeti si është bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë për Barazi Gjinore dhe komuniteteve në zyrat komunale?

**Danush Ademi** – *A ka ndarë Qeveria mjete për zbatimin e kësaj strategjie?* Shprehu shqetësimin për mospjesëmarrjen e komunitetit ashkalinj në institucionet e Kosovës dhe konsideroi se është diskriminuar ky komunitet.

*Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit iu përgjigjën Shqipe Krasniqi dhe Sadete Demaj.*

Pas një diskutimi të gjerë dhe konstruktiv, që u zhvillua për këtë pikë, Komisioni nxori këtë

### P e r f u n d i m

Komisioni të kërkojë nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta përfshijë në agjendë te seancës plenare Programin e Kosovës për barazi gjinore.

Konstatim i të gjithëve ishte: të gjenden mjete për zbatimin e detyrave që dalin nga Plani i Veprimit i Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008 dhe u apelua që në të ardhmen të ketë takime të përbashkëta.

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

Kryetari i Komisionit

---

Ismet Beqiri